

VENDIM
Nr. 624, datë 26.9.2012

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR REALIZIMIN E PROCEDURËS
DHE VEPRËS MONUMENTALE “100 VJET PAVARËSI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, t’i shtohet fondi prej 57 108 870 (pesëdhjetë e shtatë milionë e njëqind e tetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë) lekësh, për realizimin e procedurës dhe veprës monumentale “100 Vjet Pavarësi”.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha